

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA GLLOGOC

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201/26300-26-2073-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektimi ,Dezinsektimi dhe Deratizimi ne institucionet e komunes se Drenasit.**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

AMBIENTI SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtine, Mati 1, Rruga B, Obj. Inxhiniering, H 2, Nr 2.

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

(Kodi postar)

+38345645089

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Veton Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

I-mail adresa

shpk.ambienti@gmail.com



Data e parashtrimit të kërkesës: 15.07.2026

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

PRETENDIMI NJË

Shkelja e nenit 6 të LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 6 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

PRETENDIMI DY

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim dhe Mosdiskriminimi)

PRETENDIMI TRE

Shkelja e nenit 51 të LPP-së dhe nenit 40 të Rregullores për Prokurimin Publik Shkelja e Nenit 51 të LPP-së lidhur me Kapacitetin Teknik dhe Profesional.

PRETENDIMI KATËR

Shkelja e Nenit 19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

PRETENDIMI PESË

Shkelja e Nenit 40.6 të Rregullores Nr.001/2022

PRETENDIMI GJASHTË

Shkelja e Parimit të Proporcionalitetit sipas Nenit 51 të LPP-së dhe Nenit 19 të Rregullores.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI I PARË

Shkelja e Nenit 6 të LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)

Sqaroj se sipas nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues obligohet që fondet publike t'i shfrytëzojë në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive, duke siguruar që kontrata ti jepet operatorit ekonomik që posedon kapacitetet e nevojshme për realizimin e saj, kapacitetet këto të cilat ndërlidhen me kërkesat e aftësive teknike profesionale, ku autoriteti kontraktues me rastin e publikimit të njoftimit për

kontratë i ka vendosur këto keitëre të cilat më pas janë modifikuar, pothuajse janë thjeshtësuar (hjekur) sikur të ishte një procedurë me vlerë minimale.

Për të vazhduar dhe sqaruar lidhur me shklejet të cilat do ti ofrojmë dëshmitë, sqarimet dhe të gjitha inofrmatat me bazë ligjore paraprakisht do ti bashkangjesim, kriteret e njoftimit për kontratë dhe dosjes të tenderit në fazën fillesetare dhe pastaj pas korrigjimit, ju si autoritet kontraktues keni bërë reduktmin (hjekjen) e kërkesave të cilat janë në kundërshtim me LPP-në dhe nenet të cilat do ti sqarojmë në vazhdim.

Kërkesat të cilat kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, me rastin e publikimit të njoftimit për kontratë:

ka realizuar me sukses kontrata te natyres se ngjajshme ,ne tri vitet e shkuara nga data e pubikimit te njoftimit per kontrate. Në vlerë prej jo më pak se 200.000.00 euro .	e skenuar origjinale te jete e nenshkruar dhe e vulosur nga OE.Duke specifikuar emrin e projektit,shumen e kontrates,daten e fillimit dhe te mbarimit te kontrates dhe referenca apo raporte te pranimit .Referencat apo raportet e pranimit duhet te korresponojne ne listen e kontratave
2.Operatori Ekonomik të jetë i çertifikuar me ISO 9001-2015,ISO 14001-2015,ISO 45001-2018 Menaxhimi i cilësisë për shërbimet DDD.	2.Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë kopje të çertifikatës ISO 9001-2015 ISO 14001-2015 ISO45001-2018 të akredituar në Menaxhimin e Cilësisë për shërbimet e DDDs
Operatori Ekonomik Duhet ti Ket Sepaku 37 Puntor per kryerjen e sherbimeve te DDD duhet	4.Operatori Duhet te Ket Dëshmi nga Lista e ATK
B05 Njoftim per Kontrat	
4 / 7	
te ket te punsuar sepaku ne vitin 2024-2025	
Operatori Ekonomik duhet të ketë Kërkesa 5 - Caktimi i Menaxherit të Kontratës OE duhet të paraqes Menaxher të Kontratës me diplome universitare 3 vite pervoj pune pas qertifikimit si Menaxher licencuar në Menaxhim të Riskut Kontrat.	Dëshmia për Kërkesën 4. OE për Menaxherin e Kontratës duhet të paraqes Diplomën Universitare, Certifikatën e Licencimit për Menaxhimin e Riskut, Dëshmi që ka se paku 3 vite pervoj pune pas qertifikimit ne Menaxhimin e Riskut si Menaxher dëshmi qertifikata e Menaxhimit Risk vendimin për caktimin e Menaxherit të Kontratës
Operatori Ekonomik duhet të ketë Së paku (1) KIMIST BACHELOR I KIMIS INXHINIERIK UNIVERZITAR me Kontrat.	Menaxheri i Operatorit Ekonomik duhet të jetë me diplomë UNIVERZITARE BACELOR I KIMIS-INXHINIERIK MINIMUMI 3 VITE PERVOJ PUNE TE DESHMOHET ME TRUST DHE KONTRAT DHE REFERENC.
Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se është i licencuar nga institucionet kompetente për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit te Republikës se Kosovës .	9. Dëshmia kopje te Licences se lëshuar nga institucionet kompetente për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit te Republikës se Kosove
Lista e paisjeve dhe mjeteve tjera të nevojshme që duhet t'i posedoj Operatori Ekonomik.	5.Paisjet të dëshmohen përmes librezave valide të mjetit, mirëpo në rast se paisjet nuk janë në pronësi të ofertuesit, dëshmia të jetë marrëveshje për huazimin e paisjeve e nënshkruar nga dy palët përmes kontratës për qiramarrje me kohëzgjatje të projektit dhe numër të prokurimit - dhe oe duhet te bej nje deklarate te paisjeve te cilat ka ne pronesi dhe cilat ne qiramarrje. *Minimum NJEZET (20) Sperkatese per Sherbimet e DDD . Minimum Pes (5) Automjete per kryerjen e sherbimeve te DDD dhe per intervenime sa me te shpejt pas kerkeses se ak oe duhet te ket keto lloj Automjetevev , 1 Xhip, 1 Kombi, 3 Pick Up.

Kurse pas modifikimit dhe korrigjimit të njoftimit për kontratë, kërkesat duken dhe janë si në vazhdim:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
		1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata të natyres së ngjajshme, në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në vlerë prej jo më pak se 200.000.00 euro .	Dëshmia 1.Lista e kontratave duhet të dorzohet e skenuar origjinale të jetë e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE.Duke specifikuar emrin e projektit,shumen e kontratës,daten e fillimit dhe të mbarimit të kontratës dhe referenca apo raporte të pranimit .Referencat apo raportet e pranimit duhet të korrespondojnë në listën e kontratave
		Operatori Ekonomik duhet të ketë Kërkesa 5 - Caktimi i Menaxherit të Kontratës OE duhet të paraqes Menaxher të Kontratës me diplome universitare 3 vite përvij pune pas qertifikimit si Menaxher licencuar në Menaxhim të Riskut Kontrat.	Dëshmia për Kërkesën 4. OE për Menaxherin e Kontratës duhet të paraqes Diplomën Universitare, Certifikatën e Licencimit për Menaxhimin e Riskut, Dëshmi që ka se paku 3 vite përvij pune pas qertifikimit në Menaxhimin e Riskut si Menaxher dëshmi qertifikata e Menaxhimit Risk vendimin për caktimin e Menaxherit të Kontratës
		Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se është i licencuar nga institucionet kompetente për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës .	9. Dëshmia kopje të Licences se lëshuar nga institucionet kompetente për kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosove

AK, fillimisht ka vlerësuar se realizimi i shërbimeve DDD kërkon, minimum 37 punëtorë, kimist të kualifikuar, pajisje dhe automjete specifike, standarde ISO për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë, mirëpo me korrigjimin e dosjes së tenderit këto kërkesa janë eliminuar pothuajse tërësisht. AK, ka krijuar mundësinë që kontrata ti jepet një operatori ekonomik i cili nuk dëshmon se ka dhe posedon mjetet dhe stafin për realizimin e kësaj kontrate, çka nënkupton se veprim ligjor i ndërmarrë në këtë fazë shkel drejtpërdrejt parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të përcaktuar me nenin 6 të LPP-së.

PRETENDIMI I DYTË

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim dhe Mosdiskriminimi)

Referuar pretendimit numër dy, përkatësisht, neni 7 i LPP-së, ku LPP e obligon autoritetin kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë dhe konkurrencë efektive në mes të operatorëve ekonomikë.

Rrethana rënduese, diskrimnuese dhe trajtim të pabarabartë është krijuar nga autoriteti , me veprimin e ndërmarrë në reduktimin (hjekjen) e kërkesave si në, personel profesional, pajisje, automjete, staf shkencor dhe teknik, standarde të cilësisë, vendosen në pozitë të pabarabartë me operatorët që nuk posedojnë asnjërin prej këtyre kapaciteteve.

Përmes eliminimit të kriterëve që dëshmojnë kapacitetin teknik dhe profesional, AK, ka krijuar një situatë ku ne operatorët ekonomikë me kapacitete reale trajtoheni njësoj me operatorët që nuk posedojnë kapacitete të tilla, duke cenuar konkurrencën reale dhe barazinë në trajtim.

PRETENDIMI I TRETË

Shkelja e Nenit 51 të LPP-së lidhur me Kapacitetin Teknik dhe Profesional

Poashtu në nenin 51 të LPP-së, baza ligjore është se LPP e autorizon Autoritetin Kontraktues të kërkojë dëshmi mbi kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë kur këto janë të nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Vetë fakti që keni kërkuar, 37 punëtorë, kimist, pajisje profesionale, automjete, certifikime ISO, vërteton se gjatë hartimit të dosjes së tenderit ju si AK keni konstatuar se këto kapacitete janë të domosdoshme për realizimin e kontratës.

Eliminimi i tyre pa asnjë arsytim teknik, profesional apo ligjor bie ndesh me qëllimin e nenit 51 të LPP-së, i cili synon verifikimin e kapaciteteve reale të operatorëve ekonomikë para dhënies së kontratës.

PRETENDIMI I KATËRT

Shkelja e Nenit 19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Në nenin, 19.3 të rregullores Nr.001/2022, përcakton se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të qartë karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës, përfshirë cilësinë, performancën dhe sigurimin e cilësisë. Po ashtu, neni 19.4 kërkon që specifikimet të jenë të qarta, të sakta dhe të përcaktohen në mënyrë që të mos krijojnë paqartësi lidhur me natyrën e shërbimeve të kërkuara.

Kur kemi të bëjmë me shërbime DDD, të cilat përfshijnë përdorimin e preparateve kimike, personelit të specializuar dhe pajisjeve teknike, AK është i obliguar të përcaktojë kërkesa minimale që garantojnë realizimin profesional të kontratës.

Dosja e tenderit pas ndryshimit nuk përmban asnjë kriter që dëshmon posedimin e pajisjeve, automjeteve apo personelit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, duke krijuar pasiguri juridike dhe për ekzekutimin e kësaj kontrate.

PRETENDIMI I PESTË

Shkelja e Nenit 40.6 të Rregullores Nr.001/2022

Neni 40.6(c) i Rregullores përcakton se një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm kur dorëzohet nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Nëse dosja e tenderit nuk përmban kritere minimale për: personelin, pajisjet, automjetet, ekspertizën profesionale, atëherë AK në fazën e vlerësimit nuk do të ketë bazë ligjore për të verifikuar nëse operatori ekonomik fitues posedon kapacitetet reale për realizimin e kontratës.

Dosja aktuale e tenderit nuk garanton që operatori i shpallur fitues do të jetë realisht i aftë për ekzekutimin e kontratës.

PRETENDIMI I GJASHTË

Shkelja e Parimit të Proporcionalitetit sipas Nenit 51 të LPP-së dhe Nenit 19 të Rregullores.

Praktika e KRPP-së ka sqaruar vazhdimisht se proporcionaliteti nuk nënkupton vetëm shmangien e kritereve të tepruara, por kërkon që kriteret të jenë të mjaftueshme për të garantuar realizimin e kontratës sipas natyrës dhe kompleksitetit të saj.

Në rastin konkret, AK ka kaluar nga kritere të detajuara të kapacitetit teknik dhe profesional në kritere minimale që nuk mundësojnë verifikimin e fuqisë punëtore, pajisjeve operative, stafit profesional, dhe kapacitetet teknike.

Prandaj kriteret aktuale nuk janë më proporcionale me objektin e kontratës dhe nuk sigurojnë kryerjen e shërbimeve në mënyrë të sigurtë dhe profesionale.

Ne si operator ekonomik të interesuar për të konkuruar në këtë procedurë duam të sqarojmë se lidhur me kërkesën e cila është më specifike dhe më profesionale në raport me realizimin e kontratë është për kërkesën:

Kërkesa:

Operatori Ekonomik duhet të ketë Së paku (1) KIMIST BACHELOR I KIMIS INXHINIERIK UNIVERZITAR me Kontrat.

Dëshmia:

Menaxheri i Operatorit Ekonomik duhet të jetë me diplomë UNIVERZITARE BACHELOR I KIMIS-INXHINIERIK MINIMUMI 3 VITE PERVOJ PUNE TE DESHMOHET ME TRUST DHE KONTRAT DHE REFERENC.

Autoriteti kontraktues, në versionin fillestar të Dosjes së Tenderit, ka kërkuar që operatorët ekonomik të disponojë së paku një Kimist me diplomë universitare Bachelor në Kimi apo Kimi Inxhinierike, si person përgjegjës profesional për realizimin e shërbimeve DDD.

Mirëpo, përmes modifikimit të dosjes së tenderit kjo kërkesë është eliminuar pa asnjë arsyetim teknik apo profesional. Largimi i kësaj kërkesë është në kundërshtim me nenin

51 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili autorizon Autoritetin Kontraktues të kërkojë dëshmi mbi kapacitetin teknik dhe profesional kur këto janë të nevojshme dhe të lidhura me objektin e kontratës.

Gjithashtu, sipas dispozitave të Rregullores për Prokurimin Publik, kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe të mundësojnë verifikimin e aftësisë reale të operatorëve ekonomik për ekzekutimin e saj.

Shërbimet DDD nuk janë shërbime të zakonshme, por aktivitete teknike dhe profesionale që përfshijnë përdorimin e substancave kimike, përgatitjen e tretësirave, dozimin e preparateve, monitorimin e efekteve të tyre dhe kontrollin e rreziqeve për shëndetin publik dhe mjedisin.

Prandaj, kërkesa për një Kimist nuk përbën kriter diskriminues apo kufizues të konkurrencës, por është një kërkesë minimale profesionale që siguron: përdorimin e sigurt të preparateve kimike, kontrollin profesional të proceseve DDD, mbrojtjen e shëndetit publik, mbrojtjen e mjedisit, dhe realizimin cilësor të kontratës.

Vetë fakti se autoriteti kontraktues fillimisht e kishte konsideruar të domosdoshme këtë pozitë profesionale dëshmon se gjatë hartimit të dosjes kishte vlerësuar se realizimi i kontratës kërkon profesionistë (kimistë) nga fusha e kimisë. Largimi i mëvonshëm i kësaj kërkesë pa ndonjë analizë teknike apo arsyetim profesional paraqet veprim që është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe me qëllimin e nenit 51 të LPP-së.

Në vazhdim gjeni arsyet (pa arsyet) të vendimit mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Besim A. Zejnullahu B.L." të datës 12.07.2026 kundër njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me numër 611-26-4320-2-1-1 me titull "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi në institucionet e komunes së Drenasit.

II. LEJOHET autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin për kontratë të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi..

III. NJOFTOHET operatori ekonomik "Besim A. Zejnullahu B.L." si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues ka analizuar kërkesën tuaj dhe vlerëson që është e pabazuar dhe se që kriteret janë minimale pas korigjimit të procedurës andaj kërkesa për menaxher i cili nuk e ka atë caktuar pagaditjen profesionale vetëm certifikatën e menaxhimit të rriskut për shkak të natyrës së projektit i cili ka të bëjë me produkte të dezinfektimit andaj kërkesat janë të qendrueshme dhe nuk mund të ndryshohen.

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin për Prokurimin Publik.

Me Respektë !

Siq mund të shihni Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është nxjerrë në kundërshtim me refencat apo bazën ligjore, dhe kërkesat e nenit 108A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues, në arsyetimin e vendimit, është kufizuar vetëm në konstatimin se kriteret e vendosura pas korigjimit janë "minimale" dhe se kërkesa për menaxher nuk prek përgatitjen profesionale, pa ofruar asnjë analizë juridike, mbi pretendimet konkrete të ngritura nga ne si operator ekonomik ankues.

Një arsyetim i tillë nuk mund të konsiderohet arsyetim ligjor, pasi nuk përmban analizë individuale të pretendimeve, nuk trajton provat e paraqitura nga ne si operator ekonomik ankues dhe nuk shpjegon bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur Autoriteti Kontraktues për të refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim.

Në kërkesën për rishqyrtim dhe më pas në këtë ankesë janë ngritur pretendime të detajuara lidhur me shkeljen e nenit 6, nenit 7 dhe nenit 51 të LPP-së, si dhe nenit 19 dhe nenit 40 të Rregullores Nr. 001/2022, duke argumentuar se Autoriteti Kontraktues i ka eliminuar kriteret thelbësore të kapacitetit teknik dhe profesional pa asnjë analizë objektive dhe pa asnjë arsyetim profesional të cilën arsyet vetëm ai vetë e di.

Megjithatë, në vendimin e autoritetit kontraktues nuk mund të gjesh asnjë përgjigje lidhur me pyetjet thelbësore dhe kontket të ngritura nga ne si operator ekonomik ankues, konkretisht:

1.Përse janë larguar kriteret për 37 punëtorë, kimistin universitar, automjetet, pajisjet profesionale dhe certifikimet ISO ?

2. Mbi cilin raport profesional apo teknik është mbështetur Autoriteti Kontraktues gjatë ndryshimit të këtyre kërkesave?

3.Përse kriteret që vetë Autoriteti Kontraktues i kishte konsideruar të domosdoshme në fazën fillestare nuk konsiderohen më të nevojshme për realizimin e së njëjtës kontratë?

4.Cili është ndryshimi faktik ose juridik që ka justifikuar eliminimin e këtyre kërkesave, ndërkohë që objekti i kontratës ka mbetur i njëji i pandryshuar?

Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë analizë të provave të paraqitura nga ne si operator ekonomik ankues, nuk ka bërë interpretim të dispozitave të LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik, si dhe nuk ka dhënë arsye konkrete për refuzimin e secilit pretendim.

Ne si operator ekonomik ankues kemi argumentuar se vetë Autoriteti Kontraktues, në versionin fillestar të Dosjes së Tenderit, kishte konstatuar se realizimi i kontratës kërkonte kapacitete të caktuara teknike dhe profesionale, përfshirë personel profesional, kimist universitar, pajisje, automjete dhe certifikime të cilësisë. Këto kriterë janë eliminuar në fazën e korrigjimit të dosjes pa u shoqëruar me asnjë analizë teknike apo profesionale dhe pa ndonjë vendim të arsyetuar që do të demonstronte se ato nuk janë më të nevojshme.

Autoriteti Kontraktues nuk e kundërshton këtë fakt dhe as nuk jep ndonjë arsyetim se përse këto kapacitete nuk kërkohen më. Përkundrazi, ai i arsyeton me një konstatim të përgjithshëm se kriteret janë minimale, pa shpjeguar nëse këto kriterë janë të mjaftueshme për të garantuar ekzekutimin profesional të kontratës.

Një vendim i tillë nuk i mundëson operatorëve ekonomik të kuptojë arsyet reale të refuzimit

Për rrjedhojë, vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk është vetëm i gabuar në aspektin ligjor , por edhe i paarsyetuar në aspektin procedural, gjë që përbën shkelje të parimeve të transparencës dhe ligjshmërisë. Për këtë arsye, edhe vetëm mungesa e arsyetimit të mjaftueshëm përbën bazë të pavarur që Organi Shqyrtues i Prokurimit ta anulojë vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

PËRFUNDIM:

- 1. Ta aprovojë ankesën sit ë bazuar.**
- 2. Të bëhet korrëgjimi i kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.**
- 3. Të rikthejë kriteret minimale për: listën e pajisjeve dhe mjeteve të punës, numrin minimal të punëtorëve; kërkesën për kimistin dhe ta zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave pas korrëgjimit të dosjes së tenderit në përputhje me LPP-në.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke marrë për bazë të gjitha resurset njerëzore të angazhuar dhe pjesa teknike e logjistike dëmet materiale të cilat do të shkaktohen janë rreth 5.000.00 euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.